



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E STUDIMEVE, PLANIFIKIMIT DHE KOORDINIMIT TË
INVESTIMEVE

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2019

Lënda: Kthim përgjigje

Drejtuar:

_____, **Tiranë**

Në përgjigje të kërkesës suaj me datë 09.07.2019, me nr. praktike 8995 dt. 09.07.2019 ku kërkonte informacion se kur do jetë vendimmarrja e Bashkisë Shkodër në lidhje me kërkesat e bëra për shfrytëzim të hapësirës publike nga subjekte të ndryshme dhe konkretisht për subjektin _____, pas shqyrtimit të kërkesës, ju informojmë se:

Bazuar në vendimin nr. 1096 datë 28.12.2015 për Miratimin e Rregullave, Kushteve e Procedurave për Përdorimin dhe Menaxhimin e Hapësirës Publike, Neni 4, për Regjimin e hapësirave publike ekzistuese, pika 1, Hapësirat publike ekzistuese, si trotuare, rrugë, sheshe, lulishte, parqe, shëtitore, rrugëkalime e mjedise të tjera në përdorim publik, janë të pacenueshme dhe nuk mund të ndryshojnë destinacionin e tyre në shërbim të përdorimit publik, përveçse përmes dokumenteve të planifikimit, të parashikuara nga ligji.

Bashkia Shkodër është në përfundim të formalizimit të rregullores vendore të shfrytëzimit të hapësirave publike për ambulant, për këtë arsye këto lloj kërkesash janë në statusin “për trajtim”.

Gjithashtu paralelisht po punohet për verifikimin e kërkesave të tjera për hapësira publike në terren për të përjashtuar të gjitha abuzimet e mundëshme.

Me përfundimin e këtyre procedurave do të realizohet trajtimi i menjëhershëm i të gjitha kërkesave.

Duke Ju falenderuar!

KRYETAR

Voltana Ademi